

RAPORT

**Mbi Cilësinë e Përfshirjes të Grupeve të Nënperfaqësuar
në
Zgjedhjet Lokale, 14 Maj 2023**

Maj, 2023



Të gjitha të drejtat për këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

Autor:

Kristaq Kume

Maj, 2023



PASQYRA E LËNDËS

Lista e Shkurtimeve.....	4
Lista e Figurave/Tabelave.....	5
Përmbledhje Ekzekutive.....	6
Hyrje.....	7
1. Kuadri ligjor në mbështetje të demokracisë përfaqësuese në pushtetin vendor në Shqipëri.....	8
1.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.....	8
1.2. Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.....	9
1.3. Koment mbi legjislacionin për zgjedhjen e organeve të pushtetit vendor - Kodi Zgjedhor..	10
1.4. Ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.....	11
1.5. Koment mbi legjislacionin “Për vetëqeverisjen vendore”.....	13
2. Përfaqësimi komuniteteve të nënpërfaqësuar në organet që zgjidhen për vetëqeverisjen vendore	14
2.1. Qasje e partive politike ndaj parimit të përfaqësimit proporcional të komuniteteve të nënpërfaqësuar në këshillin bashkiak.....	14
2.2. Vlerësim i procesit për përgjedhjen e kandidatëve për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore.....	17
2.3. Përzgjedhja e kandidatëve për kryetar bashkie.....	20
2.4. Përzgjedhja e kandidatëve për këshillat bashkiak.....	21
3. Analiza e gjetjeve për përfaqësimin në listat e këshillave bashkiak të komuniteteve më pak të përfaqësuar	21
3.1. Metodologjia	21
3.2. Përfaqësimi i të rinjëve në lista e kandidatëve për këshillin bashkiak	22
3.3. Niveli i arsimimit të kandidatëve për antarë në këshillat bashkiak	24
3.4. Përfaqësimi komuniteteve që banojnë në zona urbane dhe rurale të bashkive në listat e kandidatëve për këshillat bashkiak	24
3.5. Përfaqësimi i komuniteteve pak të përfaqësuar në listat e kandidatëve për këshillat bashkiak	26
4. Mbi qëndrueshmërinë në detyrë në organet e pushtetit lokal.....	28
Përfundime	29
Rekomandime	30
Bibliografia.....	31

Lista e Shkurtimeve

PS	Partia Socialiste
PD	Partia Demokratike
PL	Partia e Lirisë
PDIU	Partia për Drejtësi, Integrim e Unitet
INSTAT	Instituti i Statistikave
LSI	Partia Socialiste për Integrim
Koalicioni BF	Koalicioni “Bashkë Fitojmë”
WFD	Fondacioni Westminster për Demokraci

Lista e Figurave/Tabelave

Figura nr. 1	Harta e ndarjes administrative	16
Figura nr. 2	Përqindjet e përfaqësimit në listën e kandidatëve të grupmoshave të ndryshme	23
Figura nr. 3	Struktura e listave të kandidatëve për këshillat bashkiak sipas nivelit të arsimit	24
Figura nr. 4	Përqindjet e përfaqësimit me kandidatë për këshillat bashkiak të zonave urbane dhe rurale	25
Figura nr. 5	Renditja në listën e kandidatëve e përfaqësuesve të komuniteteve rurale	26
Figura nr. 6	Përqindje e kandidatëve që kanë qenë të angazhuar në organet vetëqeverisëse të pushtetit vendor	28
Tabela nr. 1	Informacion për kandidatët nga komunitetet e nënpërfaqësuar	27

Përmbledhje Ekzekutive

Reforma për pushtetin vendor e zhvilluar në periudhën 2014-2015 ndikoi edhe në cilësinë e përfaqësimit të komuniteteve që bashkëjetojnë në një bashki. Mundësitë e përfaqësimit të komuniteteve rurale në këshillin bashkiak u zvogëlua. Këto komunitete u renditën në grupin e komuniteteve të nënpërfaqësuar në organet e vetëqeverisjes vendore.

Partitë politike e zhvilluan procesin për përzgjedhjen e kandidatëve për kryetar bashkie dhe kandidatëve për këshillat bashkiak si një proces të mbyllur brënda tyre. Komunitetet qytetare nuk u bënë pjesë konsultuese e këtij procesi.

Për të vlerësuar pritshmëritë në lidhje me përfaqësimin në këshillat bashkiak që do të dalin nga zgjedhjet lokale 14 maj 2023, të komuniteteve të nënpërfaqësuar, u analizuan listat e kandidatëve për këshilltarë në bashkitë Kukës, Shkodër, Lezhë, Tiranë, Durrës, Kavajë, Elbasan, Korçë, Lushnjë, Fier, Dimal, Skrapar, Gjirokastër, në të cilat garojnë tre subjekte politike, Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Mbështetur në rezultatet e kësaj analize dhe duke i vlerësuar ato si indikatorë tregues për të gjithë vendin, mund të pohohet se:

- Në përgjithësi partitë politike kanë hartuar lista për kandidatë për këshillat bashkiak në të cilat janë të ballancuar grup moshat e kandidatëve. Përfshirja e të rinjve në këto lista e mbështet procesin e transmentimit midis brezave të përvojave dhe të përgjegjësi për administrimin e punëve në pushtetin vendor.
- Përfshirja në shumicë absolute në listat e kandidatëve për këshillat bashkiak të qytetarëve me nivel të lartë arsimor, është tregues për vlerësimin që kanë partitë politike për nivelin e kapaciteteve profesionale që duhet të ketë këshilli bashkiak.
- Përfaqësimi në listat e kandidatëve i komuniteteve rurale është i përputhshëm me parimin e përfaqësimit proporcional. Renditja e këtyre kandidatëve në listë e bën praktikisht të pa zbatueshëm këtë parim. Qasje e partive politike ndaj komuniteteve rurale është “kërkesë për votë” dhe “mungesë në përfaqësim”.
- Komunitetet e nënpërfaqësuar si pakicat kombëtare rome dhe egjiptiane, zgjedhësit me aftësi ndryshe, mbetën të papërfaqësuar në listat e kandidatëve dhe në këshillat bashkiak që do të dalin nga zgjedhjet e 14 majit 2023.
- Partia socialiste është e angazhuar në përdorimin e mekanizmit që bën të mundur qëndrueshmërinë në grupet e këshilltarëve me përvoja në punët për administrimin e pushtetit vendor.

Për të krijuar kushte më mbështetëse për rritjen e mundësive për përfaqësimin në organet e vetëqeverisjes vendore të grupeve të nënpërfaqësuar, janë të nevojshme ndërhyrjet në legjislacion për ndryshime në organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor dhe në kodin zgjedhor për votimin për kandidatët e këshillave bashkiak me lista të hapura.

Hyrje

Koncepti i demokracisë si një sistem i qeverisjes që buron nga populli, funksionon me popullin dhe për popullin përmban dhe shpreh dy kërkesat dhe cilësitë themelore që duhet të zotërojnë dhe të demostrojë ky sistem qeverisës:

- i. Ndërtimin e mënyrave të sjelljes, organizimit dhe vendimmarrjes të nevojshme për realizimin e bashkëjetesës në shoqërinë njerëzore, në bazën e të cilës duhet të qëndrojë zbatimi i vullnetit politik të shumicës së popullit, si bartës i pushtetit politik.
- ii. Krijimin e mundësive për realizimin e lidhjeve funksionale të shtetit me popullin, si rruga e vetme për zbatimin e vullnetit të popullit.

Sistemi demokratik i qeverisjes, ndonëse konsiderohet si sistemi më mirë i ndërtuar nga shoqëria njerëzore, në asnjë rast nuk duhet të konsiderohet, dhe në asnjë rast nuk mund të realizohet si një model i përkryer dhe i paqortueshëm qeverisje. E rëndësishme është të theksohet se ky është një sistem që funksionin nëpërmjet vetkorrigjimit dhe ndryshimit të vazhdueshëm. Është sistem i cili ecën në harmoni me gjithë zhvillimet e tjera ekonomike, sociale e kulturore që ndodhin në shoqërinë njerëzore, shpesh edhe duke qenë nxitësi kryesor i tyre.

- Në shoqëritë demokratike, çdo qytetar mund dhe duhet të marr pjesë në proceset e organizimit dhe të administrimit të punëve në komunitetin ku jeton. Në thelbin e këtyre shoqërive qëndrojnë parimet: çdo qytetar është i lirë dhe ka të drejtë të informohet për çfarë ndodh dhe çfarë bëhet në vendin ku ai jeton.
- Çdo qytetar ka të drejtë të shfaq hapur mendimet e tij për çështje të ndryshme publike, çdo qytetar ka të drejtë të formulojë dhe të angazhohet në punë për arritjen e pritshmërive të caktuara në sfera dhe veprimtari të ndryshme sociale e ekonomike, të bëjë propozime për mënyra veprimi ose të paraqes kërkesa për zhvillime të caktuara social-ekonomike,
- Çdo qytetar ka të drejtë të synojë të bëhet pjesë e trupave vendimmarrëse ose të zgjedhë përfaqësuesit që dëshiron etj.

Historia e zhvillimit ekonomik e social tregon se për realizimin e bashkëjetesës në shoqërinë njerëzore, në pajtim me parimet e mësipërme, është e nevojshme që shoqëria të ndërtojë mekanizma, instrumenta, rrugë dhe menyra veprimi sa më efektive. Ndër to, si ndër më të rëndësishmet dhe kryesoret janë institucioni i votës, proceset zgjedhore dhe zgjedhjet.

Mënyra se si këto instrumenta dhe procese ndërtohen dhe realizohen janë ndër indikatorët kryesorë që shërbejnë për të gjykuar dhe për të vlerësuar nivelin e zhvillimit demokratik të një shoqërie. Ndërtimi i tyre, si rregull është një proces i gjatë, kompleks dhe i vazhdueshëm legjislativ, ndërkohë që zbatimi tyre është proces në të cilin pasqyrohet kultura e shoqërisë në përgjithësi dhe sjellja e saj ndaj kërkesave të shtetit ligjor në veçanti.

1. Kuadri ligjor në mbështetje të demokracisë përfaqësuese në pushtetin vendor në Shqipëri

1.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Në [Kushtetutën e Shqipërisë](#), neni 2 përcakton *“sovrانيتeti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit”* dhe se *“populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërdrejt”*. Ky përcaktim kushtetues është baza juridike që kushtëzon cilësinë e legjimitetit të pushtetit, sipas të cilit ushtrimi i funksioneve që u ngarkohen organeve të pushtetit, legjislativ, administrativ apo gjyqësor, e ka burimin e tij tek populli. Organet shtetërore dhe veçanërisht organet kushtetuese janë sovrane sepse në fakt ato janë instrumenta me anë e të cilave populli ushtron sovranitetin që i përket vetëm atij. Ushtrimin e sovranitetit nëpërmjet përfaqësuesve, qytetari në Republikën e Shqipërisë e realizon nëpërmjet votës. Kushtetuta përcakton se në Shqipëri *“Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme dhe periodike”*.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë janë sanksionuar liritë dhe të drejtat e shtetasve, në përputhje të plotë me dokumentat ndërkombëtar, siç janë: Konventa për të Drejtat themelore të Njeriut e OKB-së, Konventa për Liritë dhe të Drejtat Politike, etj. Kushtetuta përcakton se çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedh dhe të zgjidhet. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Në përputhje me standardet ndërkombëtare por edhe duke ju përgjigjur kushteve konkrete dhe stadit të zhvillimit demokratik të shoqërisë, Kushtetuta parashikon edhe rastet kur shtetasi përjashtohet nga e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.¹

Për vetëqeverisjen vendore në Kushtetutë përcaktohet se *“Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore”*. Në nenin 109 Kushtetuta shprehet se:

- Organet përfaqësuese të njësive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilët zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.
- Organi ekzekutiv i bashkisë ose i komunës² është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë

¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Liritë dhe të drejtat politike (Neni 45)

2. Përjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paafte mendërisht.

3. Përjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t'u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike.”

<https://qbz.gov.al/publications/constitutions>

² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 109, <https://qbz.gov.al/publications/constitutions>

dhe se

- Të drejtën e zgjedhjes në këshillat vendor dhe si kryetar bashkie ose komune e kanë vetëm shtetasit që janë me banim të përhershëm në territorin e njësisë vendore përkatëse.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, gërma dhe fryma e saj theksojnë nevojën për ndërtimin e një kuadri legjislativ, i cili të garantojë realizimin e misionit bazë që kanë njësitë e qeverisjes vendore, realizimin e një qeverisje në nivel sa më afër dhe në plotësim sa më të mirë të interesave të shtetasve. Në Kushtetutë theksohet se realizimi i këtij objekti madhor është i mundur vetëm kur organet dhe qeverisja vendore funksionojnë në përputhje me kërkesat e demokracisë përfaqësuese, vetëm kur organet e pushtetit vendor për vetëqeverisje, zgjidhen në bazë të vullnetit të komuniteteve vendore, i cili shprehet me votë, në proçese zgjedhore demokratike. Zbatimi i dispozitave kushtetuese që rregullojnë çështje të funksionimit të demokracisë përfaqësuese në vetëqeverisjen vendore, realizohet nëpërmjet zbatimit të kodit zgjedhor dhe ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”.

1.2. Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë

[Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë](#) i miratuar me ligjin Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012, nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, nr. 118/2020, datë 5.10.2020, në nenin 3 “Parime të përgjithshme” rikonfirmon parimin kushtetues sipas të cilit “Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë kod.” Në këtë mënyrë, legjisllacioni krijon bazën e nevojshme ligjore që i shërben qytetarëve për të ushtruar të drejtën e sovranit, sipas përcaktimit të bërë në Kushtetutë.

Kodi zgjedhor përcakton kushtet, kërkesat dhe procedurat që duhet të ndiqen për zgjedhjen e organeve të pushtetit vendor – kryetarin e bashkisë dhe këshillin bashkiak.

Të drejtën për të paraqitur kandidatë për kryetar bashkie ose për antarë të këshillit bashkiak ligji ia njeh partive politike ose koalicionit të partive politike, të cilat, në çdo rast, paraqesin një kandidat të përbashkët për kryetar bashkie ose një listë shumëemërore të përbashkët për antarë të këshillit bashkiak. Të drejtën për të kandiduar për kryetar bashkie ose për antar të këshillit bashkiak e ka edhe çdo shtetas me të drejtë vote, që banon në njësinë vendore përkatëse, i cili rregjistrohet si kandidat i pavarur. Për t’u regjistruar një kandidat i pavarur, ligji parashikon detyrimin për mbështetje të kandidaturës së tij prej jo më pak se 1% e zgjedhësve të regjistruar në listën e zgjedhësve në bashkinë përkatëse. Nga ky detyrim përjashtohen vetëm ata kandidatë të pavarur që janë kryetar bashkie, anëtarë të këshillit të

njesisë së qeverisjes vendore përkatëse ose deputet. Në këtë rast, kandidati paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit.

Kodi Zgjedhor në Kreu II “Sistemi i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore” neni 165 përcakton se:

- Kryetarët e bashkive si dhe këshillat e bashkive zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit me vendbanim në territorin e bashkisë.
- Anëtarët e këshillave të bashkisë zgjidhen në bazë të listave shumëëmërore të paraqitura nga partitë politike, koalicionet ose nga kandidatura të propozuara nga zgjedhësit.
- Koalicionet zgjedhore paraqesin vetëm një kandidat të përbashkët për kryetar bashkie dhe vetëm një listë kandidatësh për këshillin bashkiak.

Siç shihet kryetari i njesisë vendore zgjidhet sipas sistemit mazhoritar, me një raund³, ndërkohë që antarët e këshillit bashkiak zgjidhen sipas sistemit proporcional, me lista të mbyllura.⁴

1.3. Koment mbi legjislacionin për zgjedhjen e organeve të pushtetit vendor - Kodi Zgjedhor

Zgjedhja e kryetarit të bashkisë nëpërmjet votimit mazhoritar krijon kushte mbështetëse për funksionimin efektiv të demokracisë përfaqësuese në nivel vendor. Megjithatë, duhet të theksohet dhe të vihet në dukje fakti se përcaktimi në kodin zgjedhor i zgjedhjes së kryetarit të bashkisë, në një proces zgjedhor me një raund, e zvogëlon efektin e kësaj zgjedhjeje në cilësinë e përfaqësimit. Vendosja në kodin zgjedhor e kushtit *i pari fiton* sjell pasojë në cilësinë e këtij përfaqësimit. Ky kusht e konsideron normale zgjedhjen kryetar të bashkisë të një kandidati që nuk ka mbështetje reale, të dallueshme dhe të qënësishme në komunitet. Zgjedhja e antarëve të këshillit bashkiak nëpërmjet votimit për listën e mbyllur të kandidatëve, të paraqitur nga subjekti zgjedhor, e zvogëlon ndjeshëm cilësinë e përfaqësimit të qytetarëve në këshillin bashkiak. Zgjedhësi ka mundësi të zgjedhë vetëm subjektin, partinë ose koalicionin e partive politike. Me votën e tij ai nuk ka asnjë mundësi të shprehet

³ Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 166, “Zgjedhja e organeve të qeverisjes vendore”

1. Kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

2. Në rastin kur dy ose më shumë kandidatë marrin numër të barabartë votash, atëherë ndërmjet tyre hidhet short. Shorti organizohet nga KQZ-ja në një seancë publike, me pjesëmarrjen edhe të kandidatëve. KQZ-ja përcakton rregullat e organizimit të shortit. <https://www.osce.org/files/f/documents/5/7/477547.pdf>

⁴ Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 166, “Zgjedhja e organeve të qeverisjes vendore”

3. Mandatet e këshillave vendorë ndahen nga KQZ-ja në bazë të sistemit proporcional, sipas të njëjtave procedura të parashikuara në nenin 162 të këtij Kodi. Mandatet nominale të këshillave vendorë ndahen bazuar në listën e kandidatëve me rend zbritës, duke filluar nga numri rendor një. <https://www.osce.org/files/f/documents/5/7/477547.pdf>

për kandidatin ose kandidatët që dëshiron t'ju delegojë pushtetin për të vendosur në emër të tij.

Ndryshimet e bera në organizimin dhe ndarjen territoriale-administrative të vendit, me miratimin e ligjit [Nr. 115/2014 “Për ndarjen territoriale-administrative të Republikës së Shqipërisë”](#), sipas të cilit nga 65 bashki dhe 309 komuna, vendi u nda në 61 bashki, solli pasoja në cilësinë e përfaqësimit të qytetarëve në organet e zgjedhura të pushtetit vendor. Mundësitë reale të përfaqësimit në këto organe rezultuan se nuk janë të njëjta për të gjithë komunitetet përbërëse të popullatës së bashkisë. Në mënyrë të veçantë dallime në mundësitë për t'u përfaqësuar, me antarë në këshillat bashkiak, janë evidentuar midis komuniteteve në zonat rurale në krahasim me komunitetet e qytetarve që banojnë në zonat urbane. Përpara reformës territoriale-administrative, komunitetet në zonat rurale përfaqësoheshin në pushtetin vendor nëpërmjet të zgjedhurve prej tyre si kryetar të komunave dhe antarë në këshillat e komunave. Reforma për pushtetin vendor e zhvilluar në periudhën 2014-2015 e zëvendësoi komunën si njësi vendore me njësinë administrative, si pjesë e strukturës organizative të bashkisë. Për këtë strukturë, në kodin zgjedhor nuk ka asnjë parashikim në lidhje me zgjedhjen e organeve qeverisëse të saj. Këtë çështje trupa legjislative e ka rregulluar nëpërmjet dispozitave përkatëse në [ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”](#). Në këtë mënyrë, struktura që është më afër me komunitetin, struktura që ka mundësi më të mira dhe reale për të njohur problemet dhe kërkesat e këtij komuniteti, në veçanti në zonat rurale, është vetëm një strukturë ekzekutive, që ndërtohet mbi bazën e vullnetit dhe vendimmarrjes së kryetarit të bashkisë.

1.4. Ligji “Për vetëqeverisjen vendore”

[Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”](#) është akti legjislativ që rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre, dhe organeve përkatëse që ushtrojnë pushtetin në këto njësi.

Neni 5 i ligjit përcakton përmbajtjen e konceptit të njësive të vetëqeverisjes vendore. Sipas kësaj dispozite njësi të vetëqeverisjes vendore janë bashkitë dhe qarqet. Bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore. Ajo përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe një bashkësi banorësh. Qarku është njësi e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore. Ai përfaqëson një unitet administrative-territorial, të përbërë nga disa bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkët.

Me qëllim administrimin e punëve në shërbim të komuniteteve, për të krijuar mundësi që shërbimet të jenë sa më afër qytetarit dhe sa më shumë të përputhura me interesat e tij, ligji parashikon që çdo bashki të ndahet në disa njësi administrative. Ndarja, në çdo rast duhet të bëhet duke mbajtur parasysh lidhjet tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale të

komuniteteve që banojnë në territorin e njësisë si dhe shtrirjen në territor të zonave që përfshihen brenda njësisë administrative. Njësitë administrative përbëhen nga qytetet dhe/ose fshatrat. Qytetet mund të ndahen në njësi më të vogla që quhen lagje. Një lagje, si rregull, mund të krijohet vetëm në territore me mbi 20 mijë banorë.

Organi përfaqësues i bashkisë është këshilli bashkiak. Organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari i bashkisë. Këto dy organe zgjidhen nga qytetarët, si rregull çdo katër vjet, në përputhje dhe zbatim të kodit zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Organi përfaqësues i qarkut është këshilli i qarkut, i cili krijohet me përfaqësues nga organet e zgjedhura të bashkive që e përbëjnë atë, sipas mënyrës së përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”.

Zbatimi i reformës territoriale-administrative, e cila pati si rezultat të saj krijimin e njësive vendore, bashkive, me shtrirje në territor, në shumicën e rasteve, shumë më të madhe se të mëparëshme dhe me diversitet të lartë ekonomik, social e kulturor, kushtëzoi nevojën për të gjetur zgjidhje për zvogëlim sa më të madh të mundshëm të efekteve në cilësinë e përfaqësimit të qytetarve në organet e zgjedhura dhe cilësinë e shërbimit që këto organe duhet të ofrojnë për komunitetet. Në ligjin [nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”](#)⁵, ky problem trajtohet në kreu XI – Drejtimi dhe funksionimi i strukturave administrative të bashkisë”.

Neni 65⁶ i këtij ligji përcakton se në njësitë administrative ngrihet dhe funksionon një administratë që drejtohet nga administratori. Struktura dhe organika e administratës së njësive administrative janë pjesë të strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë. Administratori emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë. Ndërkohë neni 66 përcakton detyrat e administratës së njësive administrative ndër të cilat bëjnë pjesë:

- shërbimi për të gjitha procedurat administrative në kompetencën e bashkisë;
- mbikëqyrja e territorit për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë;
- administrimi i parqeve, lulishteve, zonat e gjelbëruara, këndeve të lojërave, tregjet publike kur për këtë urdhërohet nga kryetari i bashkisë.

[Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”](#) parashikon ngritjen dhe funksionimin e strukturave komunitare në qytetet që bëjnë pjesë në një bashki. Ngritja e tyre bëhet në bazë të iniciativës qytetare. Këto struktura emërtohen këshilla komunitarë të lagjeve.

⁵ Ligj Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

https://www.erru.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf

⁶ Ligj Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 65, Administrata e njësive administrative

1. Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori.

2. Administratori emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë dhe është përgjegjës para tij për funksionimin dhe veprimtarinë e administratës. Administratori duhet të ketë vendbanimin në njësinë administrative përkatëse.

3. Struktura dhe organika e administratës së njësive administrative janë pjesë të strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë. https://www.erru.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf

Neni 70 i ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përcakton se fshati drejtohet nga kryetari dhe kryesia e fshatit. Kryesia është organ këshillimor i kryetarit. Anëtarët e kryesisë së fshatit zgjidhen në mbledhje të fshatit, ku marrin pjesë jo më pak se gjysma e banorëve me të drejtë vote.

1.5. Koment mbi legjislacionin “Për vetëqeverisjen vendore”

Parimi kushtetues sipas të cilit vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore është një përcaktim ligjor i cili kërkon që legjislacioni që rregullon këtë vetëqeverisje, të shfrytëzojë të gjitha hapësirat e mundshme për të garantuar ndërtimin dhe funksionimin e organeve të pushtetit vendor mbi bazën e parimeve të demokracisë përfaqësuese dhe të drejtpërdrejtë. Ky përcaktim, nuk e përjashton por e ngushton ndjeshëm hapësirën për vetëqeverisje vendore nga organe të emëruar. Ndërkohë është e rëndësishme të theksohet se Kushtetuta nuk vendos kufinj, në kuptimin e madhësisë së territorit ose të komunitetit, nën të cilët parimi kushtetues për vetëqeverisje nëpërmjet organeve përfaqësuese, organeve të zgjedhura me votën e shtetasve, mund të anashkalohet. Për pasojë zgjidhjet e fiksuar në kodin zgjedhor dhe mënyra se si e trajton dhe e zgjidh problemin e ndërtimit të organeve të qeverisjes vendore, në nivele më të ulta se ai i njësisë bazë vendore, bashkisë, ligji për vetëqeverisjen vendore nuk është i përputhur me frymën e Kushtetutës.

Njësitë administrative, të cilat korespondojnë me komunat e djeshme ose, për bashkinë e Tiranës edhe me njësitë bashkiake, aktualisht qeverisen nga të emëruar, me vendim të kryetarit të bashkisë. Vendimarrjet për çështje të ndryshme të vetëqeverisjes vendore për komunitetet e këtyre njësive administrative janë eskuzivitet i këshillit bashkiak. Në këtë këshill është plotësisht e mundshme që të mos ketë asnjë antar që të ketë lidhje reale dhe të përfaqësojë interesat e komunitetit të njësive administrative përkatëse. Ndërkohë, duke ju referuar detyrave që ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ngarkon administratorit, nga njëra anë dhe nga ana tjetër, faktit se ai është i emëruar në detyrë nga kryetari i bashkisë, pa vështirësi mund të arrihet në përfundimin se për komunitetet në njësinë vendore, në veçanti për njësitë territori i të cilave shtrihet në zona rurale, qeverisja vendore e ka të vështirë të realizojnë shërbime efektive në interes dhe në plotësim të kërkesave të tyre. Praktikisht këto komunitete qeverisen nga organe ekzekutive dhe parimi i vetëqeverisjes për to është mjaft i cunguar.

Për të zvogëluar efektin që krijohet në zbatimin e parimit të vetëqeverisjes, në veçanti në bashkitë relativisht të mëdha, efekt që është pasojë e zgjedhjes nga qytetarët e vetëm kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak, siç është theksuar edhe më sipër, ligji për vetëqeverisjen vendore parashikon ngritjen dhe funksionimin e këshillave komunitar në qytete dhe lagjet e tyre dhe këshillit dhe kryetarit të fshatit. Objekti kryesor i punës së këtyre

këshillave është mbështetja e funksioneve vetëqeverisëse të bashkisë në lagjen/fshatin përkatës. Si mekanizma që shërbejnë për të lehtësuar punën e bashkisë, këto këshilla e kanë pothuajse zero mundësinë për të vepruar si institucione që përfaqësojnë vullnetin e komuniteteve ku ato veprojnë.

2. Përfaqësimi komuniteteve të nënpërfaqësuar në organet që zgjidhen për vetëqeverisjen vendore

Praktikat e derisotme të zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor tregojnë se komunitetet që bashkëjetojnë në të njëjtën njësi vendore nuk kanë barazi propocionale për të qenë të përfaqësuar në këto organe. Në këtë rast bëhet fjalë për përfaqësimin e tyre në këshillin bashkiak, i cili është një organ kolegjal që zgjidhet nga populli. Kryetari i bashkisë i cili zgjidhet nëpërmjet një gare mazhoritare, nuk ka arsye të qënësishme të kërkohej edhe për t'u zgjedhur në pajtim me kërkesat e parimit të përfaqësimit propocional të komuniteteve. Ndërkohë, mund të theksohet se mënyra se si është parashikuar në legjislacionin shqiptar zgjedhja e kryetarit të bashkisë, sistem mazhoritar me një raund, cilësitë përfaqësuese të këtij organi si rregull janë më pak se sa do të ishin në rastin kur zgjedhja do të bëhej me dy raunde. Legjislacioni ynë nuk ka të ndërtuar por as nuk kërkohej që të ndërtohen mekanizma ligjor të cilit të bëjnë të mundur që për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë të merret në konsideratë rregullimi i përfaqësimit në këtë organ të komuniteteve më pak të përfaqësuar. Në këtë legjislacion është trajtuar vetëm rasti kur komunitete të caktuara, të cilët bëjnë pjesë në komunitetet e nënpërfaqësuar, kanë peshë të konsiderueshme, lehtësisht të dallueshme, në krahasim me të tjerët. Ligji nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", për të tillë raste ka parashikuar formimin e njësive vendore të veçanta si janë p.sh. bashkia Pustec, bashkia Dropull, etj. në organet vetëqeverisëse të të cilëve janë përfaqësuar denjësisht komunitetet e pakicave kombëtare përkatëse.

2.1. Qasje e partive politike ndaj parimit të përfaqësimit propocional të komuniteteve të nënpërfaqësuar në këshillin bashkiak

Këshilli i bashkisë si institucioni kryesor vendimmarrës për vetëqeverisjen vendore, anëtarët e të cilit zgjidhen nga komunitetet që bashkëjetojnë në njësinë vendore përkatëse, duhet të zotrojnë cilësinë e përfaqësimit propocional të këtyre komuniteteve. Niveli i plotësimit të kësaj cilësie është faktor që ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e punës së këtij institucioni. Duke parasysh faktin se, në zbatim të legjislacionit tonë, zgjedhja e antarëve të këshillit bashkiak bëhet nëpërmjet votimit të listës së kandidatëve, të cilat paraqiten nga subjektet, parti politik ose koalicione të tyre, që këshilli bashkiak të zotrojë cilësi përfaqësimi në

përmbushje të kërkesave të parimit të përfaqësimit propocional, duhet që të plotësohet, njëkohësisht dy kushte:

- (i) Në listën e kandidatëve për antarë të këshillit bashkiak, partitë politike ose koalicionet e tyre, duhet të përfshijnë kandidatë që përfaqësojnë në mënyrë propocionale të gjithë komunitetet që bashkëjetojnë në njësinë vendore përkatëse
- (ii) Renditja e kandidatëve në listë të bëhet duke patur si synim krijimin e mundësive, propocionalisht të barabarta, për të marr mandat këshilltari, nga mandatet që subjekti fiton, secili nga përfaqësuesit e komuniteteve të ndryshme.

Përfshirja në listën e kandidatëve për këshillin bashkiak të përfaqësues të komuniteteve të ndryshme që bashkëjetojnë në një bashki jo vetëm që nuk është kusht që i vendos partitë politike në vështirësi por, përkundrazi ato tregohen shumë të vëmendshme dhe të angazhuara për të realizuar një përfshirje të tillë. Në këtë mënyrë partitë politike kanë mundësi t'ju kërkojnë votën për këshillin bashkiak të gjithë komuniteteve. Ndërkohë, ndaj kërkesës që lidhet me kushtin e dytë, partitë politike janë shumë refraktare. Për rrjedhojë në listat e kandidatëve për këshillat bashkiak, megjithëse partitë politike përfshijnë edhe kandidatë që i përkasin komuniteteve rome, egjiptiane, personave me aftësi ndryshe ose kandidatë që banojnë në zona rurale, emrat e tyre i vendosin në vendet e fundit në listë, duke e bërë pothuajse zero, të pamundur, fitimin e mandatit të këshilltarit nga ndonjëri prej tyre. Kjo është pasojë e faktit se, si është theksuar edhe më sipër, sistemi zgjedhor sipas të cilit zgjidhen këshillat bashkiak në Shqipëri është sistem propocional, me lista të mbyllura. Për pasojë, renditja e kandidatëve në listë është faktor përcaktues për të fituar ose jo mandat këshilltari. Si rregull partitë politike, duke mos patur asnjë detyrim ligjor në lidhje me mundësitë reale që duhet të krijojnë për funksionimin e parimit të përfaqësimit propocional, i rendisin emrat e këtyre kandidatëve në listë duke mos përdorur si kriter peshën që zë komuniteti që përfaqëson secili prej tyre por duke ju referuar, më shumë së çdo gjëje tjetër, pëlqimit politik.

Reforma për pushtetin vendor e kryer në vitet 2014-2015 dhe harta për ndarjen territoriale - administrative të vendit, si një prej produkteve të saj, ka ndikuar në zvogëlimin e cilësisë së përfaqësimit propocional të komuniteteve që bashkëjetojnë në një bashki të caktuar. Në mënyrë të veçantë kjo situatë është pasojë e zvogëlimit të mundësive për përfaqësim, në këshillin bashkiak, të komuniteteve që banojnë në zonat rurale të bashkisë. Këto komunitete rezultojnë se janë pak të përfaqësuara në këshillin bashkiak. Arsytet e një situatë të tillë janë të njëjta me ato që u renditen më sipër për komunitete e tjera pak të përfaqësuara. Qasja e partive politike ndaj komuniteteve që banojnë në zonat rurale nuk ka dallime thelbësore nga qasja e tyre ndaj komuniteteve të tjera të



Figura nr. 1 Harta e ndarjes administrative
Ligji nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të
njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

nënpërfaqësuar. Problemet që në procesin e reformës së fundit për pushtetin vendor, *apriori* parashikohej se do të shoqëronin funksionimin e demokracisë përfaqësuese në nivelin lokal, nxiten nevojën e rregullimeve dhe gjetjen e zgjidhjeve ligjore që do të shërbenin për të zbutur efektet negative të tyre. Kjo është edhe një ndër arsyt kryesore pse në ligjin "Për vetëqeverisjen vendore" parashikohet ndërtimi i mekanizmave me anën e të cilëve synohet të plotësohen hapësirat boshe, hapsirat ku nuk vepron në mënyrë efektive demokracia përfaqësuese, të cilat krijohen nga mungesa e zgjedhjeve direkt nga populli i organeve vetëqeverisëse në nivele të ulta. Të tillë mekanizma janë-këshillat komunal dhe këshilli i fshatit, të cilat ligji i parashikon si organe që zgjidhen nga komunitetet por jo si pjesë e zgjedhjeve periodike për pushtetin lokal. Ndërkohë, mënyra se si e trajton ligji procesin e

zgjedhjes së tyre dhe detyrat, të drejta dhe kompetencat që ligji ka përcaktuar për to, ka bërë që, në fakt ato të jenë vetëm instrumenta formal, si rregull, zgjatime politike të kryetarit të bashkisë.

Është e rëndësishme të theksohet se pavarësisht se problemet me të cilët përballët funksionimi i demokracisë përfaqësuese në nivelin vendor njihen dhe pranohen, për trajtimin e tyre dhe për gjetjen e zgjidhjeve sa më efektive, referuar kushteve sociale, politike e ekonomike të vendit, përpjekjet që duhet të bëjnë partitë politike edhe pushteti legjislativ për të gjetur këto rrugë zgjidhje mungojnë.

Zgjedhjet për organet e pushtetit vendor të 14 majit 2023 janë zgjedhjet e treta lokale pas reformës të bërë për pushtetin vendor, në periudhën 2014-2015. Për nevojat e analizës që bëhet, rezultatet e marra në zgjedhjet e zhvilluara në 30 qershor 2019, nuk mund të shërbejnë si referencë dhe objekt analize. Këto zgjedhje u zhvilluan si një proces atipik⁷. Rezultatet e arritura në zgjedhjet e viti 2015, treguan se mënyrat se si legjislacioni i ynë i trajton çështjet që lidhen me organizimin, zgjedhjet dhe funksionimin e organeve të

⁷ Në zgjedhjet për organet e pushtetit vendor, të zhvilluara në 29 qershor 2019, partitë e opozitës i bojkotuan, nuk morën pjesë. Për rrjedhojë, kandidatët e Partia socialiste, si kandidatë të vetëm, fituan mandatin e kryetarit në 59 bashki të vendit. Këshillat bashkiak, në të gjitha bashkitë e vendit i përkisnin Partisë socialiste. Pavarësisht se, në aspektin formal ligjor këto zgjedhje u pranuan, ato ishin zgjedhje jo tipike për një shoqëri dhe sistem demokratik qeverisje.

vetëqeverisjes vendore, kanë nevojë për t'u rikonsideruar. Pjesë e domosdoshme e problemeve që duhet të jenë objekt diskutimi dhe trajtimi për gjetjen e zgjidhjeve më efektive, duhet të jenë edhe çështjet që lidhen me nevojën për përmirësimin e kushteve ligjore dhe ndryshimet në sjelljen e partive politike për rritjen e mundësive për përfaqësim në këshillin bashkiak të komuniteteve më pak të përfaqësuara.

Në mbështetje të përpjekjeve për të mirëorientuar zhvillimin këtij procesi kompleks ligjor e politik, mund të shërbejnë edhe gjetjet e monitorimit, analizës dhe vlerësimit të përfaqësimit të komuniteteve të nënpërfaqësuar në zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore, 14 maj 2023, që janë objekt i këtij raporti. Si dihet, procesi zgjedhor që është duke u zhvilluar nuk u parapri nga asnjë ndryshim në nënlegjislacionin që trajton çështje të organizimit në territor të pushtetit vendor dhe nuk u bë asnjë ndryshim edhe në kodin zgjedhor. Pra, në aspektin legjislativ zgjedhjet po zhvillohen në të njëjtat kushte si u zhvilluan edhe në vitin 2015. Kjo rrethanë e bën të pranueshme dhe të nevojshme analizën dhe, nëpërmjet saj, gjykimin për cilësinë e përfaqësimit të komuniteteve pak të përfaqësuara, pakicave kombëtare rome e egjiptiane, komunitetin e personave me aftësi ndryshe dhe komunitetet që banojnë në zonat rurale të bashkisë, në këshillat bashkiak që do të dalin nga zgjedhjet, duke ju referuar listave të kandidatëve, që partitë politike kanë dorëzuar në KQZ.

Analiza e listave të kandidatëve për antarë në këshillat bashkiak do të targetojë probleme që lidhen me: (i) raportet e përfaqësimit të grupmoshave të ndryshme të kandidatëve në këto lista, (ii) nivelin e arsimimit të tyre, (iii) vendi i banimit, qytet/fshat, (iv) komunitetit që i përkasin, (v) përvojës që kanë në punën në organet e pushtetit vendor dhe (vi) mundësisë që kanë për të fituar mandat këshilltari nga mandatet që do të fitojë subjekti që ka hartuar listën.

2.2. Vlerësim i procesit për përgjedhjen e kandidateve për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore

Për sa kohë që zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore kanë si objektiv të tyre ndërtimin e organeve lokale për vetëqeverisjen vendore, karakteri i tyre është thelbësisht administrativ. Këto janë zgjedhje nëpërmjet të cilave qytetarët, banorë të bashkisë, zgjedhin përfaqësuesit e tyre, të cilëve iu japin të drejtat që të administrojnë problemet e komuniteteve që bashkëjetojnë në një territor të caktuar. Për pasojë, ndryshe nga zgjedhjet politike, zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, për kandidatët që garojnë për kryetar bashkie ose për këshilltar bashkiak, nuk ka pse të jetë kërkesë thelbësore përkatësia e tyre politike, kontributi dhe pozita që ata mund të kenë në partinë politike që i kandidon. Si kriter kryesor që duhet zbatuar në përzgjedhjen e këtyre kandidatëve, duhet të jenë aftësitë e tyre për të administruar punët publike, përgatitja dhe njohuritë profesionale, integriteti social e kulturor i tyre, etj. Një qasje e tillë ndaj këtyre kandidaturave është ngushtësisht e lidhur me faktin se

detyrat që do të kryejnë kandidatë të tillë nesër, kur të ushtrojnë mandatin që ju japin zgjedhësit, janë detyrat e një administratori të punëve lokale. Nuk janë detyra plotesimi i të cilave lidhet direkt dhe i shërbejnë, në rradhë të parë dhe kryesisht, realizimit të objektivat dhe synimet politike të partisë që i kandidon. Detyrat e tyre janë ngushtësisht të lidhura me zbatimin në punët e përditshme komunitare të kërkesave të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, realizimi i të cilave nuk duhet të ndikohen, në asnjë rast, nga preferencat ose përkatësia politike e tij. Për të realizuar këtë veçori thelbësore që duhet të zotrojnë kandidatët që garojnë për t’u zgjedhur në organet vetëqeverisëse vendore, partitë politike, që janë edhe subjektet përgjegjëse që përzgjedhin këta kandidatë dhe hartojnë listat e tyre, duhet që procesin e përzgjedhjes së tyre ta ndërtojnë dhe ta realizojnë mbi parime që ndryshojnë nga parimet në bazën e të cilave hartojnë listat për kandidatët për deputetë. Ndër cilësitë thelbësore që duhet të ketë procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore është përfshirja sa më e madhe e qytetarëve, komuniteteve që bashkëjetojnë në bashkinë përkatëse, në procesin e përzgjedhjes së këtyre kandidatëve. Partitë politike duhet që këtë proces përzgjedhje të mos e realizojnë si një proces të mbyllur, politik, brenda vetes së tyre. Procesi duhet të orientohet drejt qytetarëve. Mendimeve dhe vlerësimeve të tyre partitë politike duhet t’ju japin përparësi kur marrin vendim për kandidatët që duhet të përzgjidhen. Për të realizuar këtë proces konsultimi me qytetarët partitë politike mund të përdorin rrugë dhe mekanizma të ndryshëm, si mund të jenë organizimi i anketave *on line* me qytetarë, zhvillim i primareve me pjesëmarrjen e qytetarëve etj...

Për të gjykuar në lidhje me procesin e përgjedhjes së kandidatëve për zgjedhjet lokale, 14 maj 2023, u monitorua ky proces i zhvilluar nga dy subjektet kryesore, PS dhe Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Ndërkohë për PD zyrtare ky proces nuk u monitorua. Përfaqësues të kësaj partie nuk deklaruan në asnjë rast se ishin angazhuar në një proces të tillë. Në deklaratat e tyre për këtë proces ata kanë shprehur vetëm qëndrimin e tyre në raport me procesin e përzgjedhjes, nëpërmjet primareve, të kandidatëve për kryetar bashkie, të zhvilluar nga PD – Grupi i Rithemelimit.

Për përgjedhjen e kandidatëve Partia Socialiste dhe Koalicioni “Bashkë Fitojmë” kanë deklaruar:

Partia Socialiste

Procesi i përzgjedhës të kandidatëve për kryetar bashkie si përherë do të zhvillohet si një proces i hapur për këdo, ku marrja e mendimit/vlerësimit si brenda nesh, por mbi të gjitha të zgjedhësve është themeli i këtij procesi. Objektivi i ynë, është shprehur Taulant Balla, Kryetar i Grupit Parlamentar i Partisë Socialiste është të përfshijmë në listën e kandidatëve për këshilla bashkiak sa më shumë profesionistë të rinj, kandidatë që të përfaqësojnë

komunitete me një shpërndarje dhe mbulim me përfaqësim të të gjithë bashkisë, ne duam që ekspertiza më e mirë ekonomike, juridike, bujqësore, arsimore, shëndetësore etj., të përfaqësohet në këto këshilla më 14 maj 2023. Ne, ka theksuar z. Balla, do të përzgjedhim kandidatë të cilët do të bëjnë të mundur një ndryshim rrënjësor në punën e këshillit bashkiak. Ne synojmë të ndërtojmë këshilla bashkiak tërësisht të ndryshme dhe efektive nga sa kanë qenë deri më sot: të hapura dhe transparente për qytetarët, të jenë kuvende vendore të komuniteteve lokale jo sallat e mbyllura me anëtarë që nuk i njeh as lagjia e tyre⁸.

Koalicioni “Bashkë Fitojmë”

Në Vendimin nr. 38 “Për miratimin e rregullores mbi modalitetet e përzgjedhjes së kandidatëve në zgjedhjet e pushtetit vendor - Partia Demokratike e Shqipërisë” përcakton se përzgjedhja e kandidatëve për kryetar të bashkisë do të realizohet nëpërmjet procesit të primareve, si një proces gjithëpërfshirës. Kandidat në primare ka të drejtë të jetë çdo antar i Partisë Demokratike ose dhe çdo qytetar që do të kandidojë nën siglën e kësaj partie. Çdo kandidat për primare ka mundësi të bëjë fushatë për të paraqitur programin e tij tek antarësia e partisë. Aktivitetet e fushatës duhet të jenë të hapura edhe për qytetarët, që nuk janë antarë të partisë. Çdo qytetar që dëshëron mund të marr pjesë në procesin e votimit në primare.- theksohet në këtë vendim.⁹

Për përzgjedhjet e kandidateve për këshilla bashkiak, Partia e Lirisë, si parti udhëheqëse e Koalicionit “Bashkë Fitojmë“, në të cilin bëjnë pjesë Partia e Lirisë, Partia për të Drejtat e Njeriut dhe Partia Demokristiane, hartoi dhe shpërndau në të gjithë strukturat lokale të partisë një dokument në të cilin janë të përcaktuar kriteret e përzgjedhjes së listës të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023¹⁰ publikuan ndonjë platformë proceduriale të veçantë. Në marrëveshjen politike midis Partisë së Lirisë (PL) dhe Partisë Demokratike (Grupi i rithemelimit) u theksua se PL do të mbështet kandidatët që do të dalin nga Primaret në garën për kryetar bashkie, ndërkohë që vetë do të garojë në të gjithë bashkitë për këshillat bashkiak. PL deklaroi se përzgjedhja e kandidateve për këshillat bashkiak do të bëhet duke ju dhënë përparësi të rinjve, arsimit të tyre dhe duke synuar që në listën e kandidatëve të përfshihen sa më mirë të jetë e mundur, intelektual, personalitet, pedagogë dhe përfaqësues të komuniteteve rurale¹¹.

⁸ https://www.youtube.com/watch?v=lc1KY_AefWQ

⁹ Vendim 38: Për miratimin e rregullores mbi modalitetet e përzgjedhjes së kandidatëve në zgjedhjet e pushtetit vendor - Partia Demokratike e Shqipërisë (pdsh.al)

¹⁰ Udhëzim, Nr. 1, datë 18.02.2023, “Për kriteret e përzgjedhjes së listës të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. <https://partiaelirise.al/kriteret-e-perzgjedhjes-se-listes-te-kandidateve-per-anetare-te-keshillit-bashkiak-per-zgjedhjet-per-organet-e-qeverisjes-vendore-te-dates-14-maj-2023/>

¹¹ <https://kohajone.com/video-ilir-meta-ne-krye-te-listave-tona-per-keshillat-bashkiake-do-jene-figura-intelektuale/>

2.3. Përzgjedhja e kandidatëve për kryetar bashkie

Pavarësisht nga deklaratimet për përzgjedhjen e kandidateve për zgjedhjet lokale, 14 maj 2023, partitë politike aktualisht po garojnë me kandidatë për kryetar bashkie të cilët janë në garë, në rradhë të parë sepse janë antarë të partive përkatëse dhe janë të zgjedhur në organe drejtuese, në qendër ose bazë, të këtyre partive. Këto dy subjekte zgjedhore në asnjë bashki nuk garojnë me kandidatë që nuk zotërojnë këto cilësi.

Në garën për kryetar të bashkisë, Partia Socialiste ka kandiduar rreth 75% të kryetarve aktual të bashkive që e kanë fituar këtë mandat në zgjedhjet e vitit 2019. Fakt ky që mjafton për të pohuar se deklarimi për përzgjedhjen e kandidatëve për kryetar bashkie nëpërmjet një procesi “të hapur për këdo, ku marrja e mendimit/vlerësimit si brënda nesh, por mbi të gjitha të zgjedhësve është themeli i këtij proces” mbetet vetëm një deklaratë politike por e pa konkretizuar në praktikë.

Koalicioni “Bashkë Fitojmë” garon për kryetar bashkie me kandidatat që kanë dal nga primaret. Ky proces u zhvillua si një proces politik brënda partisë, si një proces në të cilin pjesëmarrja e qytetarve të paangazhuar si kandidat ose votues nuk ndodhi. Për rrjedhojë edhe pse primaret e çliruan procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për kryetar bashkie nga vendimarrja e lidershipit të partisë, ato nuk arritën të realizoheshin si një proces për qytetarët dhe me qytetarët.

Në partitë e tjera politike si PD, PDIU, Lëvizja Bashkë etj, nuk pati proces përzgjedhje. Kandidatët u caktuan nga lidershipi i partisë pa bërë paraprakisht konsultim me qytetarë dhe as antarësinë e tyre.

Përzgjedhja e kandidatëve për këshillat bashkiak në të gjitha këto parti u zhvillua si një proces i mbyllur në strukturat drejtuese të partive në njësitë vendore përkatëse, nën tutelën e lidershipit të tyre. Monitorimi i procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për kryetar bashkie rikonfirmon faktin se, pavarësisht, se atyre që do të zgjidhen në këtë detyrë, ligji nuk iu jep hapësira për vendimarrje në interes të forcës politike që i mandaton, interesi i partive politike ishte që në këtë detyrë të kenë përfaqësues besnik të tyre. Ndërkohë, duhet të theksohet edhe fakti se një situatë e tillë nuk është vetëm pasojë e kësaj qasje të partive politike ndaj zgjedhjeve për organet e vetëqeverisjes vendore. Faktor me efekt të ndjeshëm në këtë situatë dhe qasje sjellje të partive politike është edhe niveli i pamjaftueshëm i kulturës dhe i aftësive që ka shoqëria jonë për të ushtruar demokracinë vendore. Është ky faktor negativ efekti i të cilit ka si rezultat faktin që, në zgjedhjet lokale të 14 maj 2023 vetëm 2 qytetarë, nga 61 të mundshëm, garojnë si kandidatë të pavarur për kryetar bashkie¹².

¹² **Kandidat i pavarur -kryetar bashkie**
Bashkia Sarandë – Gjergji Merkuri
Bashkia Devoll – Çlirim Hoxha

2.4. Përzgjedhja e kandidatëve për këshillat bashkiak

Përzgjedhja e kandidatëve për këshillat bashkiak nga Partia Socialiste u zhvillua si një proces në të cilin kujdesi kryesor ishte përfshirja në listë e antarëve të partisë, me kujdes të shtuar përzgjedhjen ndër ta, të atyre që janë caktuar dhe kryejnë detyra në institucionet qeverisëse qendrore ose lokale. Renditja e kandidatëve në listë është bërë e tillë që t'i krijojë sa më shumë mundësi për t'u zgjedhur kandidatëve që janë "më të pëlqyer" nga partia. Nga analiza e listave të kandidatëve të Partisë Socialiste, mund të pohohet se, gjatë hartimit të tyre është treguar kujdes që të përfshihen në lista edhe kandidatë që iu përkasin komuniteteve më pak të përfaqësuara. Në veçanti bie në sy kujdesi i treguar për të kandiduar persona nga komunitetet rurale. Më i vogël ka qenë kujdesi për të përfshirë në listë kandidatë përfaqësues të komuniteteve më pak të përfaqësuara si komuniteti rome, egjiptian dhe/ose persona me aftësi ndryshe.

Listat e kandidateve për këshillat bashkiak të Koalicionit "Bashkë Fitojmë", duke qenë lista në të cilat duhet të kishte kandidatë nga tre partitë përbërëse të koalicionit si dhe nga PD (grupi i rithemelimit) nuk krijuan mundësi për zbatimin e plotë të objektivit të deklaruar nga Partia e Lirisë në lidhje me përfshirjen në përqindje të lartë në këto lista të të rinjve. Duke qenë një listë e vetme për të gjithë partitë e koalicionit, partitë politike kanë synuar që të përfshijnë sa më shumë përfaqësues nga antarësia e tyre. Në këtë mënyrë është zvogëluar ndjeshëm mundësia që në listat e kandidatëve për këshilltarë bashkiak të koalicionit "Bashkë Fitojmë" të regjistroheshin edhe qytetarë, përfaqësues të komuniteteve të ndryshme, pa qenë në të njëjtën kohë edhe anëtarë të partive dhe pjesëtarë të koalicionit.

Numri i qytetarëve që garojnë si kandidatë të pavarur është i vogël, vetëm 8 qytetarë në katër bashki të vendit.¹³ Konkretisht, në bashkitë Kurbin, Sarandë, Rrogozhinë dhe Dibër.

3. Analiza e gjetjeve për përfaqësimin në listat e këshillave bashkiak të komuniteteve më pak të përfaqësuar

3.1. Metodologjia

Analiza ka si objektivë kryesor të gjykohet në lidhje me qasjen e partive politike, si subjekte zgjedhore, ndaj kërkesave që duhet të plotësohen për funksionimin efektiv të demokracisë përfaqësuese në pushtetin vendor. Gjykimin mbi këtë qasje do të bëhet nëpërmjet analizës së listave të kandidatëve me të cilët garojnë në zgjedhjet e 14 majit 2023 tre subjektet kryesore zgjedhore, Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Koalicioni "Bashkë Fitojmë".

¹³ Kandidat i pavarur-këshilli bashkiak

Bashkia Kurbin, Diogjen Kolici dhe Rinaldo Pinoli
Bashkia Sarandë, Ibrahim Bajrami dhe Sonaldo Nebo
Bashkia Rrogozhinë, Mitat Daja dhe Fatjon Biba
Bashkia Dibër, Astrit Ademi dhe Agim Hysa

Vëmendje e shtuar në këtë analizë i kushtohet problemit të përfaqësimit në këto zgjedhje të grupeve të nënpërfaqësuar, siç janë komunitetet e pakicave kombëtare rome e egjiptiane, zgjedhësit me aftësi ndryshe dhe komunitetet që banojnë në zonat rurale të bashkive. Për nevojat e analizës janë konsultuar listat e kandidatëve për këshillat bashkiak që këto subjekte zgjedhore kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe në plotësim të informacionit që përmbajnë këto lista, u komunikua me përfaqësues të këtyre subjekteve zgjedhore në nivel lokal.

Informacioni i analizuar lidhet me:

- (i) numrin e kandidatëve sipas grupmoshave të tyre, të ndara në tre grupe <30 vjeç, 30-40 vjeç dhe > 40 vjeç;
- (ii) numri i kandidatëve sipas nivelit arsimor të tyre- i mesëm, i lartë;
- (iii) numri i kandidatëve sipas vendbanimit qytet, zonë rurale;
- (iv) numri i kandidatëve që i përkasin grupeve të nëpërfaqësuar rome, egjiptiane, zgjedhës me aftësi ndryshe;
- (v) numri i kandidateve sipas përvojave të mëparshme në punën në organet e vetëqeverisjes vendore;
- (vi) numri i kandidatëve sipas klasifikimeve të mësipërme, të regjistruar në pesë vendet e para në listën e kandidatëve, në vendin e gjashtë deri tek i dhjeti dhe pas vendit të dhjetë.

Ky informacion është marr për bashkitë Kukës, Shkodër, Lezhë, Tiranë, Durrës, Kavajë, Elbasan, Korçë, Lushnjë, Fier, Dimal, Skrapar, Gjirokastrë. Në listat e këtyre partive janë të regjistruar, nga secila prej tyre 572 kandidatë, që përbëjnë rreth 36% të të gjithë kandidatëve për të 61 bashkitë e vendit. Bashkitë për të cilat do të kryhet analiza, janë një kampion në të cilën bëjnë pjesë të gjithë llojet e bashkive të vendit referuar madhësisë së tyre: Tiranë - 61 këshilltarë, Durrësi, Elbasani, Fieri- 51 këshilltarë, Shkodra, Lezha, Korça, Lushnja – 41 këshilltarë, Kukësi, Kavaja, Gjirokastrë – 31 këshilltarë, Dimal-21 këshilltarë, Skrapar-15 këshilltarë.

3.2. Përfaqësimi i të rinjve në lista e kandidatëve për këshillin bashkiak

Për të gjykuar në lidhje me nivelin e përfaqësimit të të rinjve në listat e kandidatëve për këshillat bashkiak, mbështetur në metodologjinë e hartuar, u llogarit përqindja mesatare e këtij përfaqësimit në listat e PS, PD dhe Koalicioni BF. Sipas përcaktimit të INSTAT, të rinjtë konsiderohen të gjithë kandidatët e grup moshës më të vogël se 30 vjeç. Rezultate e këtyre llogaritjeve jepen në Figurën nr. 2.

Siç shihet, në listat e kandidatëve të koalicionit “Bashkë Fitojmë” është përqindja më e madhe e përfaqësimit të të rinjve, (grup-mosha më e vogël se 30 vjeç), rreth 8.9% më e lartë se sa përqindja që zënë kandidatët që i përkasin të rinjve në listat e PS dhe rreth 6.5% më e

lartë se sa të rinjtë në listat e Partisë Demokratike zyrtare. Ndërkohë, ajo që bie në sy është përqindja e lartë që zënë kandidatët e grup-moshës 30-40 vjeç në listat e Partisë Socialiste, e cila është rreth 40% më e lartë se sa tek listat e PD zyrtare dhe rreth 25.5% më e lartë se tek listat e koalicionin BF.

Këto rezultate shërbejnë për të gjykuar në lidhje me tendencën që karakterizon sjelljen e partive politike në raport me marrëdhëniet midis brezave. Natyrisht, duke ju referuar situatës në të cilën është duke u zhvilluar ky proces zgjedhor, gjykimet mund të kenë vlerë përfaqësuese për Partinë Socialiste, ndërkohë që për Partinë Demokratike dhe koalicionin BF gjykimi duhet të merren me rezervë.




Figura nr. 2. Përqindjet e përfaqësimit në listën e kandidatëve të grupmoshave të ndryshme

Përzgjedhja e kandidateve për këshilltarë bashkiak nga Partia Socialiste, tek të cilët mbizotëron grup-mosha 30-40 vjeç mund të shërbejë si indikator që pasqyron politikën e kësaj partie për konsolidimin e stafeve qeverisëse vendore dhe për krijimin e mundësive më të mira për shkëmbimin e përvojave qeverisëse në pushtetin vendor, midis gjeneratave të njëpasnjëshme. Në rastin e PD zyrtare situata në lidhje me strukturën e grup-moshave në listat e kandidatëve mund të jetë rezultat më së shumti i kushtëzuar nga vështirësitë e kësaj force politike për të angazhuar kandidatë për këshillat bashkiak dhe jo rezultat i ndonjë politike aftëgjatë dhe të konsoliduar të saj. Tek koalicioni BF ndërthuren interesat e disa partive politike, të cilat garojnë me një listë të përbashkët dhe, për rrjedhojë, struktura e grupmoshave është e vështirë të shërbejë për të gjykuar në lidhje me qasjen e tyre ndaj marrëdhënieve midis brezave në kuadër të përgjegjësisë që ato kanë si parti politike që kërkojnë mandate në organet e vetëqeverisjes vendore.

3.3. Niveli i arsmimit të kandidatëve për antarë në këshillat bashkiak

Qasja e partive politike ndaj kërkesave për nivelin e arsimit të kandidatëve për antarë në këshillat bashkiak është pothuajse e njëjtë (Figura nr.3). Përqindje më e lartë e kandidatëve për këshilltarë që kanë arsim të lartë vlerësohet tek listat e Partisë Socialiste. Kjo përqindje është rreth 2.4 pikë përqindje më e lartë se sa tek listat e PD-së zyrtare dhe rreth 5.1 pikë përqindje më e lartë se sa tek listat e koalicionit BF. Pra në 572 kandidatë të këtij koalicionin vetëm 29 prej tyre janë me arsim të mesëm.




Figura nr. 3 Struktura e listave të kandidatëve për këshillat bashkiak sipas nivelit të arsimit të tyre

3.4. Përfaqësimi komuniteteve që banojnë në zona urbane dhe rurale të bashkive në listat e kandidatëve për këshillat bashkiak

Të dhënat për përqindjet e përfaqësimit me kandidatë në listat për anëtarë në këshillat bashkiak të komuniteteve urbane dhe rurale, të zbatuara nga subjektet zgjedhore të marra në analizë, tregojnë se midis tyre nuk kanë ndryshime thelbësore. Në listat shumëemërore të Partisë Socialiste kandidatët nga zonat rurale përbëjnë rreth 37% të të gjithë kandidatëve, ndërkohë që koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka përfshirë në listat e tij shumëemërore rreth 31% kandidatë që banojnë në zonat rurale. Partia Demokratike zyrtare e ka më të ulët këtë përqindje, rreth 27.4%.

Duke ju referuar përqindjeve që zënë komunitetet rurale në popullatën e përgjithshme që banon në bashkitë e marra në analizë, rezulton se përqindjet e mësipërme të përfaqësimit në listat e kandidatëve për këshilltarë respektojnë kërkesat e parimit të përfaqësimit proporcional. Ndërkohë, siç është theksuar edhe më sipër për të respektuar këtë parim nuk mjafton vetëm respektimi i tij duke përfshirë në listë numër kandidatësh nga zonat rurale sipas kërkesave të tij. Për ta bërë real këtë parim përfaqësimi në strukturën e këshillit bashkiak që do të dal nga zgjedhjet, duhet që të tregohet kujdes edhe për renditjen e këtyre kandidatëve në listë. Çdo parti politike këtë duhet ta bënte duke u mbështetur në

parashikimin për numrin e mandateve që mund të fitojë për secilën nga bashkite ku garon për këshillin bashkiak.





Figura nr. 4 Përqindjet e përfaqësimi me kandidatë për këshillat bashkiak të zonave urbane dhe rurale

Analiza e rezultateve të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të zhvilluara në 2015 ka treguar se, pavarësisht se në listat e kandidatëve partitë kryesore politike, PS, PD e LSI kishin bërë kujdes për të përfshirë në lista e tyre kandidatë që iu përkisnin komuniteteve rurale, si pasojë e renditjes së tyre në listë, numri i këtyre kandidatëve që fituan mandatin e këshilltari ishte shumë i vogël, gati i papërfillshëm. Në ato zgjedhje komunitetet rurale u bënë pjesë e komuniteteve të nënpërfaqësuar.

Për të gjykuar dhe për të vlerësuar mundësitë për t'u përsëritur i njëjti fenomen edhe në zgjedhjet që do të zhvillohen në 14 maj 2023, u analizuan të dhënat e marra nga partitë politike në lidhje me renditjen në listë të kandidatëve të komuniteteve rurale. Duke patur parasysh se tre subjektet zgjedhore, PS, PD zyrtare dhe koalicioni “Bashkë fitojmë” janë subjekte që, referuar fuqisë elektorale të tyre, parashikohet se do të jenë fituesit kryesor të mandateve për këshillat bashkiak, prej tyre u kërkua vetëm numri i kandidatëve nga zonat rurale të renditur në pesë vendet e para në listë, në vëndin e gjashtë deri tek i dhjetë dhe poshtë vendit të dhjetë.

Të dhënat e paraqitura në Figurën nr. 4 tregojnë se në tre subjektet e marra në analizë, përqindja e kandidatëve për këshilltarë që banojnë në zonat rurale, të pozicionuar deri në vëndin e dhjetë, kundrejtë numrit total të të gjithë kandidatëve përfaqësues të komuniteteve rurale, është më e lartë në listat e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, rreth 34.5%. Partisë Socialiste ka të pozicionuar në këto vende rreth 26.8% e të gjithë kandidatëve të saj, përfaqësues të komuniteteve rurale, ndërsa Partia Demokratike zyrtare ka regjistruar në këto vende rreth 23.5% të numrit të përgjithshëm të kandidatëve përfaqësues të zonave rurale.



Figurë nr.5 Renditja në listën e kandidatëve e përfaqësuesve të komuniteteve rurale

Duke patur parasysh përqindjen e përfaqësimit të kandidatëve që ju përkasin komuniteteve rurale në totalin e listës së kandidatëve, për secilin nga këto tre subjekte zgjedhore, rezulton se në listat e Partisë Socialiste kandidatët që ju përkasin komuniteteve rurale dhe që janë të pozicionuar në vendet 1-10 në listë përbëjnë rreth 10 përqind të të gjithë kandidatëve, për Partinë Demokratike rreth 6.4 përqind dhe për koalicionin ‘Bashkë Fitojmë’ rreth 10.6 përqind. Për pasojë, megjithëse në listën e kandidatëve të këtyre subjekteve përfshirja e kandidateve nga zonat rurale e respekton kërkesën e përfaqësimit proporcional, në fakt, në këshillat bashkiak që do të dalin nga zgjedhjet e 14 maj 2023 komunitetet rurale do të jenë shumë pak të përfaqësuara. Në këto zgjedhje janë të mëdha mundësitë që për përfaqësimin e këtyre komuniteteve në këshillin bashkiak të përsëritet një situatë e ngjashme si ajo që rezultoi pas zgjedhjeve lokale të vitit 2015.

3.5. Përfaqësimi i komuniteteve pak të përfaqësuara në listat e kandidatëve për këshillat bashkiak

Për të gjykuar në lidhje me nivelin e përfaqësimit në listat e këshillave bashkiak të komuniteteve pak të përfaqësuar, nga subjektet zgjedhore u kërkuar informacion në lidhje me numrin e kandidatëve që përfaqësojnë komunitetet e pakicave kombëtare, rome e egjiptiane dhe numrin e kandidatëve nga komuniteti i zgjedhësve me aftësi ndryshe. Përveç numrit të këtyre kandidatëve u kërkuar informacion edhe në lidhje me renditjen e këtyre kandidatëve në listë. Rezultatet jepen në Tablën nr. 1. Të dhënat e kësaj table tregojnë se të tre subjektet e marra në analizë nuk i kanë kushtuar vëmendjen që duhet, në respektim të parimit të përfaqësimit proporcional, përfaqësimit në listat e kandidatëve për këshillat bashkiak të komuniteteve të nënpërfaqësuara, rome, egjiptiane dhe zgjedhësve me aftësi ndryshe. Veç kësaj edhe në rastet kur në listë janë përfshirë kandidatë nga këto komunitete,

mundësia që ndonjë prej tyre të fitojë mandatin e këshilltarit është pothuajse zero. Këta kandidatë janë renditur në vende që praktikisht nuk e japin këtë mundësi.

Tabla nr. 1 Informacion për kandidatët nga komunitete e nënpërfaqësura

Nr.	Kategoria	Numri i kandidatëve		
		PS	PD	Koalicioni BF
1.	Komuniteti Rom-Gjithsej kandidatë	9	4	11
	Nga këta:			
	Të renditur në 5 vendet e para	-	-	-
	Të renditur në vendet 6-10	-	-	-
	Të renditur më poshtë	9	4	11
2.	Komuniteti Egjyptian-Gjithsej kandidatë	11	4	4
	Nga këta:			
	Të renditur në 5 vendet e para	-	-	-
	Të renditur në vendet 6-10	2	1	-
	Të renditur më poshtë	9	4	4
3.	Persona me aftësi të kufizuar-Gjithsej kandidatë	4	1	4
	Nga këta:			
	Të renditur në 5 vendet e para	-	-	-
	Të renditur në vendet 6-10	-	-	-
	Të renditur më poshtë	4	1	4

Duke qënë se kërkesës për këtë informacion nuk ju përgjigjën të gjithë subjektet dhe për rrjedhojë, mbështetur në numrat e mësipërm nuk mund të llogaritet përqindja e përfaqësimit në listën e kandidatëve të këtyre komuniteteve, referuar numrit total të kandidatëve (572) në lista e subjekteve që analizohen, informacioni që japin të dhënat e mësipërme mund të shërbejë vetëm si pasqyrim i një tendence të dukshme të qasjes ndaj këtyre komuniteteve nga partitë politike. Ndërkohë, duke qënë se, nga njëra anë subjektet e tjera zgjedhore i kanë të vogla mundësitë që të fitojnë më shumë se një mandat për këshilltar në këshillin bashkiak, dhe nga ana tjetër duke qënë se mundësitë që këto subjekte të kenë të renditur në vendet e para në listat e tyre, kandidatë që ju përkasin këtyre komuniteteve, në këshillat bashkiak që do të dalin nga zgjedhjet e 14 majit 2023 numri i këshilltarëve që ju përkasin komuniteteve rome, egjyptiane dhe personave me aftësi ndryshme pritet të jetë i papërfillshëm.

4. Mbi qëndrueshmërinë në detyrë në organet e pushtetit lokal

Rezultatet e punës të organeve për vetëqeverisjen vendore në një masë të konsiderueshme varen prej nivelit të aftësive dhe përgatitjes profesionale të të zgjedhurve. Të zgjedhurit vendor dhe në mënyrë të veçantë antarët e këshillave bashkiak duhet të kenë njohuri sa më të plota për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor dhe për detyrat që ata kanë si antarë të këtij këshilli. Është e domosdoshme që këshilltarët jo vetëm të dinë se cili është roli dhe misioni i tyre por edhe të zotërojnë aftësi profesionale për realizimin me sukses të punës. Në cilësinë e këshilltarit bashkiak ata janë përfaqësues të komuniteteve që i kanë zgjedhur, veprojnë dhe duhet të marrin vendime në përputhje me interesat e këtyre komuniteteve. Në asnjë rast nuk duhet ta kryejnë detyrën e këshilltarit si një “borxh” që duhet t’ia kthejnë partisë politike që i ka kandiduar.

Realizimi i punëve në këshillin bashkiak në plotësim të detyrës sipas qasjes së mësipërme është një ndër problemet dhe sfidat e rëndësishme me të cilat përballlet funksionimi i pushtet vendor. Veprimi për zgjidhjen e këtij problemi fillon që me hartimin e listës së kandidatëve për këshillat bashkiak. Përveç kujdesit që duhet të bëhet nga partitë politike që në këto lista të përfshihen kandidatë me nivelit të lartë arsimor dhe që t’ju përkasin profesioneve të ndryshme, mekanizëm tjetër i rëndësishëm që partitë politike mund të përdorin është angazhimi i tyre për formimin e grupeve të qëndrueshme me këshilltarë bashkiak me përvojë në këtë detyrë. Për të gjykuar dhe për të vlerësuar se në çfarë niveli është përdorur ky mekanizëm në hartimin e listave për këshilltarët bashkiak që garojnë në zgjedhjet vendore, 14 maj 2023, mund të shërbejnë të dhënat e paraqitura në Figurën nr. 6 më poshtë




Figura nr. 6 Përqindje e kandidatëve që kanë qënë të angazhuar në organet vetëqeverisëse të pushtetit vendor

Të dhënat tregojnë se Partia Socialiste e ka përdorur mekanizmin që mundëson krijimin e grupeve të këshilltarëve bashkiak me përvojë në punët që bën pushteti vendor. Natyrisht një fakt i tillë është rrjedhojë edhe e vendimit të kësaj partie për të rikandiduar rreth 75% të të gjithë kryetarëve aktual që e kanë fituar mandatin në zgjedhjet e vitit 2019. Ndërkohë, Partia

Demokratike zyrtare dhe koalicioni “Bashkë Fitojmë” kanë përfshirë në listat e kandidatëve një numër relativisht të vogël të ish këshilltarëve bashkiak të tyre ose të punonjësve që kanë kryer detyra në organet e pushtetit vendor kur këto subjekte kanë qenë në mazhorancë në bashkitë përkatëse.

Një situatë e tillë, që tregon se një pjesë e konsiderueshme e këshilltarëve që do të dalin nga zgjedhjet e 14 majit 2023, janë pa përvoja në punët e pushtetit vendor, trajnimi dhe aftësiimi profesional i tyre është një ndër punët që duhet të planifikohet për t’u bërë mënjëherë pas konstituimit të këshillave bashkiak.

Përfundime

Mungesa e ndryshimeve në kodin zgjedhor dhe në legjislacionin që trajton çështje të organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor, është faktor që, në parim, pengon përmirësimin e cilësisë së përfaqësimit të grupeve të nënpërfaqësuar në organet që do të zgjidhen për vetëqeverisjen vendore, në zgjedhjet lokale, 14 maj 2023. Pavarësisht nga deklaratimet e bera, përzgjedhja e kandidateve për kryetar bashkie dhe kandidatëve për këshillat bashkiak nga partitë politike u bë si një proces i mbyllur, i cili nuk arriti të krijonte kushte reale mbështetëse për pjesëmarrjen edhe të qytetarëve në të.

Mbështetur në analizën e listave të kandidatëve për këshillat bashkiak, me të cilat garojnë subjektet Partia Socialiste, Partia Demokratike zyrtare dhe koalicioni “Bashkë Fitojmë” në rreth 21% e të gjithë bashkive të vendit, mund të pohohet se:

- Në listat e kandidatëve subjektet politike kanë arritur të përfaqësojnë, në mënyrë të ballancuar grup moshat e kandidatëve. Përfshirja e të rinjëve në këto lista e mbështet procesin e transmentimit midis brezave të përvojave dhe të përgjegjësive për administrimin e punëve në pushtetin vendor.
- Përfshirja, në shumicë absolute, në listat e kandidatëve për këshilltar bashkiak të qytetarëve me nivel të lartë arsimor, është tregues për vlerësimin që kanë partitë politike për nivelin e kapaciteteve profesionale që duhet të ketë Këshilli bashkiak.
- Përfaqësimi në listat e kandidatëve i komuniteteve rurale është i përputhur me parimin e përfaqësimit proporcional. Renditja e këtyre kandidatëve në listë e bën praktikisht të pa zbatueshëm këtë parim. Qasje e partive politike ndaj komuniteteve rurale është e tipit “kërkesë për votë” dhe “mungesë në përfaqësim”.
- Komunitetet e nënpërfaqësuar si pakicat kombëtare romë e egjiptiane, zgjedhësit me aftësi ndryshe, mbetën të papërfaqësuar në listat e kandidatëve dhe në këshillat bashkiak që do të dalin nga zgjedhjet e 14 majit 2023.
- Partia Socialiste është e angazhuar në përdorimin e mekanizmit që bën të mundur qëndrueshmërinë në grupet e këshilltarëve me përvoja në punët për administrimin e pushtetit vendor.

Rekomandime

- Për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë nëpërmjet një procesi që krijon kushte më të mira për shprehjen sa më të plotë dhe sa më efektive të vullnetit të zgjedhësve për kandidatin që dëshirojnë t'i japin mandatin, zgjedhjet duhet të zhvillohen me dy raunde.
- Për të krijuar kushte reale për funksionimin e parimit të përfaqësimit propocional të komuniteteve që bashkëjetojnë në një bashki apo në këshillin bashkiak, janë të nevojshme ndërhyrjet që duhet të bëhen në legjislacion.
- Për të zvogëluar fenomenin e nënpërfaqësimit të komuniteteve të ndryshme në organet e pushtetit vendor, partitë politike dhe Kuvendi i Shqipërisë rekomandohet ta trajtojnë këtë problem nëpërmjet një prej dy rrugëve të mëposhtme:
 - Realizimit të reformës për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor duke synuar rritjen e mundësive për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në organet e pushtetit lokal për të gjithë komunitetet, nëpërmjet:
 - i. rikonfigurimit të hartës për ndarjen administrative territoriale të vendit dhe/ose
 - ii. zgjedhjes, si pjesë e procesit të zgjedhjeve lokale, të organeve për vetëqeverisjen vendore, në nivelin e njësive administrative.
 - Ndryshimeve në kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë në të cilin të përfshihen dispozita që:
 - i. ndryshojnë sistemin aktual sipas të cilit zgjidhen këshillat bashkiak duke parashikuar zgjedhjen e këshilltarëve sipas kërkesave të sistemit propocional, me lista të hapura;
 - ii. detyrojnë partitë politike për hartimin e listave të kandidatëve për këshillin bashkiak në përputhje me kërkesat e parimit të përfaqësimit propocional në këto lista të të gjithë komuniteteve që bashkëjetojnë në bashkinë përkatëse.

Bibliografia

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
<https://qbz.gov.al/publications/constitutions>
2. Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i miratuar me ligjin Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012, nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, nr. 118/2020, datë 5.10.2020
<https://www.osce.org/files/f/documents/5/7/477547.pdf>
3. Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë
https://aam.org.al/wp-content/uploads/2018/11/Ligj_115-2014_31.07.2014.pdf
4. Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
https://www.erru.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf
5. [Vendim 38: Për miratimin e rregullores mbi modalitetet e përzgjedhjes së kandidatëve në zgjedhjet e pushtetit vendor - Partia Demokratike e Shqipërisë \(pdsh.al\)](#)
6. Udhëzim nr. 1, datë 18.02.2023. “Për kriteret e përzgjedhjes së listës të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.
<https://partiaelirise.al/kriteret-e-perzgjedhjes-se-listes-te-kandidateve-per-anetare-te-keshillit-bashkiak-per-zgjedhjet-per-organet-e-qeverisjes-vendore-te-dates-14-maj-2023/>

Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) është institucion publik i Mbretërisë së Bashkuar që mbështet demokracinë në të gjithë botën. Me shtrirje ndërkombëtare, WFD punon me parlamentet, partitë politike, grupet e shoqërisë civile dhe me zgjedhjet që të ndihmojë t'i bëjë sistemet politike të shteteve më të drejta, më përfshirëse dhe llogaridhënëse.



www.wfd.org



@WFD_Democracy



@WestminsterFoundation



Fondacioni Westminster për Demokraci është një organ ekzekutiv publik i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit.



**British Embassy
Tirana**